




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY


 REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr Prot. _____
 B: Prot. _____
 Prot No 03-03/1607/18

Data _____
 Datum 08-06-2018

PRISHTINE

DATE/A:	08.06.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1589/18
PËR/ZA/TO:	z. Afrim BAJRAKTARI Drejtor i Departamentit të Prokurimi Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
CC:	z. Esat KELMENDI Sekretar i Përgjithshëm i Universiteti Prishtinës “Hasan Prishtina”
NGA/OD/FROM:	z. Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Servisimi dhe mirëmbajtja e Ashensorëve ne UP-ë Hasan Prishtina” me nr. të prokurimit 242/18/3995/221, nr. të brendshëm 90400/18/008/221.

I nderuar z. Bajraktari,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Servisimi dhe mirëmbajtja e Ashensorëve ne UP-ë Hasan Prishtina”** me nr. të prokurimit 242/18/3995/221, nr. të brendshëm 90400/18/008/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Servisimi dhe mirëmbajtja e Ashensorëve ne UP-ë Hasan Prishtina”** me nr. të prokurimit 242/18/3995/221, nr. të brendshëm 90400/18/008/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat

përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 08 qershor 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1589/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Servisimi dhe mirëmbajtja e Ashensorëve ne UP-ë Hasan Prishtina”** me nr. të prokurimit 242/18/3995/221, nr. të brendshëm 90400/18/008/221, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar 45,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional në kërkesën B, është kërkuar: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë dy (2) kontrata për furnizime dhe shërbime të ngjashme, me vlerën prej 68,000.00€, të realizuara për periudhën e shkuar 3 vjeçare”*, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2 parashihet se “Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se këtë rast do të duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitura referencat për përfundimin e kontratave në vlerë totale të gjithë referencave të shërbimeve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, e jo si në rastin konkret ku janë kërkuara 2 (dy) kontrata në vlerë prej 68,000.00€.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencë e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët mund të ofrojnë furnizime të tilla të kënaqshme.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shitesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

